

## Mitropoliti i Ruses bëri thirrje për përgjegjësi dhe vaksinim



Zoti ia ka dhënë të drejtën çdo një të krishteri ortodoks për të zgjedhur lirisht nëse të vaksinohet apo jo, por ai duhet të jetë i vetëdijshëm se është përgjegjës për shëndetin e tij dhe për shëndetin e të tjerëve. Këtë e shkroi në profilin e vet në Facebook Mitropoliti i Ruses Naum, njoftoi BNT.

“Çdo sugjerim që zgjon frikë tek njerëzit dhe u imponon atyre një ndjenjë mëkatore në rast vaksinimi është plotësisht i paarsyeshëm dhe manipulues”, tha kleriku i lartë. Mitropoliti këshilloi të gjithë që duan të vaksinohen të konsultohen me mjekët e tyre familjarë dhe të mos u besojnë “burimeve të tjera anësore”.